



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 416/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi, Kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me apelet e parashtruara nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit dhe ndikimit tek rezultati final, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN të pasafatshme apelet: Anr.416/2019 dhe Anr.418/2019 të datës 07.11.2019, të paraqitura nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit dhe ndikimit tek rezultati final, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet Anr.416/2019 dhe Anr.418/2019 të datës 07.11.2019, nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka(SLS), duke pretenduar se kanë vërejtur keqpërdorim (falsifikim) të nënshkrimit personal për votat e ardhura përmes postës, duke keqpërdorur identitetin e personave.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i që të angazhon grafologun për vërtetimin e identitetit të falsikuesit të nënshkrimit në fletëvotimet e ardhura me postë, dhe të njëjtat të rinumërohen.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 119 par.1 të LZP-së. Në rastet konkrete qendra e votimit është mbyllur më datë 06.10.2019 në ora 19:00, ndërsa apelet: Anr.416/2019 dhe Anr.418/2019, nga apeluesi janë paraqitur në PZAP, me datë 07.11.2019, që do të thotë pas afatit të paraparë ligjor të përcaktuar me nenin 119 par.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart e në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.416/2019 më datën 08.11.2019

Kryesuesi i Panelit

Brustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.